# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5494
E martë, 5 qershor 2018
çmimi 0.40 €


## Haradinaj takohet me Metën: Shqiptarët po faktorizohen

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", BAJRAM HASANI FAQE 4-5

# Zonat ekonomike mundësojnë zhvillim më të madh të bizneseve



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka thënë se vendi ynë ka pasur nevojë për krijimin e zonave ekonomike, të cilat do të bëjnë të mundur zhvillim më të madh të bizneseve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hasani ka thënë se MTI-ja ka ndërmarrë shumë hapa për mbrojtjen e prodhuesve vendorë. Ai ka paralajmëruar se në cilëndo fushëveprimtari që prodhuesit ankohen se po dëmtohen nga importi, MTI-ja do të ndërmarrë masa për mbrojtjen e tyre. Hasani ka bërë me dije se MTI-ja ka nisur reformën për ristrukturimin e inspektorateve në nivel vendi, e cila në fund do të rezultojë me mënyrën më të mirë të funksionimit të tregut dhe garantimit të standardeve. Duke folur për bashkëpunimin Kosovë - Shqipëri, ai ka thënë se ka rritje të shkëmbimit tregtar, po prapëseprapë mbetet ende i ulët

## Opozita nuk do ta votojë platformën për dialogun me Serbinë




Dy partitë më të mëdha opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), kanë paralajmëruar se nuk do ta votojnë platformën për dialogun me Serbinë. Sipas tyre, platforma shtetërore për dialog, e prezantuar nga Qeveria në Kuvendin e Kosovës, është e dobët dhe joserioze. Përfaqësuesit e këtyre subjekteve e kanë quajtur gabim në hapa hartimin e kësaj platforme FAQE 7



## Presidenti ia dorëzon BE-së letrat për përfundimin e mandatit të EULEX-it

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ua ka dorëzuar autoriteteve të EULEX-it letërkëmbimin i cili parasheh përfundimin e mandatit ekzekutiv të këtij misioni. Letra, e cila është negociuar ndërmjet palës së Kosovës dhe asaj të BE-së, parasheh edhe reduktimin e rolit të EULEX-it në rol monitorues dhe këshillues në fazën e përmbylljes së misionit FAQE 3

## AKTUALE

### PRESIDENTI DUHET TA UDHËHEQË DIALOGUN F. 11



SALI BILSIMI

### KUVENDI NUK E MIRATON KËRKESËN E VETËVENDOSJES PËR SHKARKIMIN E DËRGUTIT F. 3

### NIS STUDIMI I FIZIBILITETIT PËR SHSKUK-në F. 6

## EKONOMI

### RISHPALLET KONKURSI PËR DREJTOR MENAXHUES NË KEK F. 9

### KOSID-i: FOKUSI NË QYMYR, BARRIERË PËR TRANZICIONIN E ENERGJISË NË KOSOVË F. 9

## KULTURË

### SOT HAPET PANAIRI I LIBRIT NË PRISHTINË F. 18

## SPORT

### LLAPI 'BLINDON' ZHDRELLËN DHE NAMANIN, LARGOHET DAKU F. 18

### LOWI BEFASON SËRISH, LË SANEN JASHTË BOTËRORIT F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
SatStyro
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Borissovi: Shqipëria meriton hapjen e negociatave

TIRANË, 4 QERSHOR - Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, deklaroi të hënën në Tiranë se Shqipërisë duhet t'i jepet një datë dhe rrugë për fillimin e negociatave për anëtarësimi në Bashkimin Evropian. Ai këto komente i bëri në një konferencë të përbashkët për media me homologun e tij shqiptar Edi Rama, me të cilin ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit në procesin e integrimit të Shqipërisë. Borissovi ka cituar kancelaren gjermane Angela Merkel të këtë thënë se Ballkani Perëndimor është tema më e vështirë që mund të zgjidhet. "Sa më mirë të jetë rajoni, aq më të mëdha janë mundësitë për bashkëpunim. Shqipërisë duhet t'i jepet një datë dhe rrugë për fillimin e negociatave. Tregojmë përpjekje që duhet t'i bindim shtetet skeptike deri në fund të qershorit", tha ai.

Ndërsa kryeministri Rama e vlerësoi homologun e tij se ka bërë avokatin e Shqipërisë në rrugën e saj të integrimit. "Marrëdhënia me Bullgarinë është jashtëzakonisht pozitive. Borisovi ka bërë avokatin e Shqipërisë në BE. Miqtë tanë bullgarë na ofrojnë ndihmën me përvojën e tyre", tha kryeministri Rama.



# Haradinaj takohet me Metën: Shqiptarët po faktorizohen

Kryeministri Ramush Haradinaj gjatë një vizite në Shqipëri është takuar me presidentin Ilir Meta, me të cilin ka biseduar për proceset politike që po kalojnë të dy vendet. Haradinaj ka thënë se shqiptarët po faktorizohen duke marrë përgjegjësitë e tyre për t'i kontribuar paqes së qëndrueshme në rajonin tonë

TIRANË, 4 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës në Tiranë, është pritur të hënën në takim nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në të dy vendet.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast shprehu falënderimin e tij dhe të popullit të Kosovës për ndihmën e pakursyer që kanë dhënë institucionet e Shqipërisë në të gjitha periudhat për Kosovën. "U jemi mirënjohës për kontributin tuaj dhënë Kosovës në të gjitha periudhat e vështira dhe tani në procesin e integrimeve evropiane si proces i domosdoshëm dhe për të cilën Republika e Kosovës ka nevojë më shumë se kurrë për përkrahjen e gjithanshme", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se shqiptarët po faktorizohen duke marrë përgjegjësitë e tyre për t'i kontribuar paqes së qëndrueshme në rajonin tonë.



Duke folur rreth bashkëpunimit bilateral ndërmjet të dy vendeve dhe zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, të dy bashkëbiseduesit u pajtuan të këtë një dinamikë të shtuar në këtë drejtim.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se është e nevojshme përkrahja e institucioneve të Shqipërisë për Kosovën në lobim më të madh për shtimin e numrit të njohjeve dhe për anëtarësim në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Ndërkaq, presidenti Ilir Meta ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të institucionit që udhëheq për përkrahjen e Kosovës në të gjitha proceset, me theks për rrugën euroatlantike të saj.



### Haradinaj: Erion Veliaj e ka kthyer Tiranën në qytet evropian

Kryeministri Ramush Haradinaj e ka takuar të dielën kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Haradinaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Erion Veliaj e ka kthyer Tiranën në qytet me pamje e shkëlqim evropian. "Të parin e kryeqytetit shqiptar e përgëzova për infrastrukturën moderne, transportin publik funksional, parqet dhe rrjetin brilant të kopshteve për fëmijë. Erioni duhet t'u shërbejë si model kryetarëve të qyteteve shqiptare për zgjidhjet efektive, që bën për komunitetin, si dhe për shpirtin që ua jep hapësirave urbane", ka shkruar Haradinaj.

## Bushati në Japoni për thellimin e marrëdhënieve ekonomike

TIRANË, 4 QERSHOR - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, ka nisur të hënën një vizitë në Japoni, gjatë së cilës do të takohet me homologun japonez Taro Kono. "Në fokus të kësaj vizite është bashkëpunimi dypalësh dhe thellimi i marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve. Në këtë optikë, të hënën ministri Bushati zhvilloi takime me ministrin japonez të Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Hiroshige Seko, presidentin e Federatës Japoneze të Biznesit, Yoshio Sato, si dhe mori pjesë në aktivitetin e organizuar me këtë rast nga Ambasada e Shqipërisë në Tokio "Një ditë shqiptare në Tokio", për promovimin e fushave dhe veprimtarisë së biznesit shqiptar në tregun japonez dhe të Shqipërisë si një destinacion potencial për investitorë japonezë", ka njoftuar kabineti i ministrit Bushati.

Në takimin me ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Hiroshige Seko u diskutua në lidhje me stadin aktual të marrëdhënieve ekonomike, shtimin e mëtejshëm të tyre dhe përqendrimin në fusha specifike si infrastruktura, turizmi dhe bujqësia. "Ministri Bushati falënderoi për ndihmën e deritanishme japoneze me projekte për zhvillim", duke theksuar se ka ardhur koha që marrëdhëniet ekonomike të marrin një hov të ri edhe në kontekstin e Nismës japoneze të bashkëpunimit me Ballkanin Perëndimor.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Presidenti ia dorëzon BE-së letrat për përfundimin e mandatit të EULEX-it

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ua ka dorëzuar autoriteteve të EULEX-it le tërkëmbimin i cili parasheh përfundimin e mandatit ekzekutiv të këtij misioni. Letra, e cila është negociuar ndërmjet palës së Kosovës dhe asaj të BE-së, parasheh edhe reduktimin e rolit të EULEX-it në rol monitorues dhe këshillues në fazën e përmbylljes së misionit. Por, njohësit e çështjeve të drejtësisë dhe të sigurisë në vend kanë shprehur nevojën e vazhdimit të mandatit të EULEX-it



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën ka dorëzuar tek autoritetet e Bashkimit Evropian (BE) letërkëmbimin me përfaqësuesen e lartë për politikë të jashtme e siguri, Federica Mogherini, me të cilin përmbyllet mandati i deritashëm i EULEX-it. Letrën e kanë pranuar komandanti i operacioneve civile të PPSM-së, Kenneth Deane, si dhe shefja e EULEX-it, Alexandra Papadopoulou.
Përmbajtja e letrës është negociuar në mes të palës së Kosovës dhe asaj të BE-së dhe parasheh përfundimin e mandatit ekzekutiv dhe reduktimin e rolit të EULEX-it në rol monitorues dhe këshillues në fazën e përmbylljes së misionit. "Ka qenë një dekadë e vlefshme për Kosovën", u shpreh presidenti Thaçi në këtë takim, duke shtuar se "institucionet e Kosovës kanë përfituar shumë nga bashkëpunimi me EULEX-in". "Falë këtij bashkëpunimi sot kemi ngritur kapacitetet vendore për t'i marrë plotësisht përgjegjësitë në sektorin e sundimit të ligjit", u shpreh ai.
Presidenti Thaçi shtoi se "EULEX-i ka qenë mision i suksesshëm dhe nga kjo përvojë edhe BE-ja mund të nxjerrë mësime të rëndësishme për misionet e ngjashme në të ardhmen".
Mandati i misionit të EULEX-it skadon më 15 qershor 2018, kurse misioni i ardhshëm do të jetë i përqendruar në përmbylljen e transferimit të plotë të kompetencave tek organet e Kosovës si dhe në përmbylljen e misionit.
Ndonëse institucionet e Kosovës janë shprehur se Kosova nuk ka nevojë më për këtë mision, njohësit e çështjeve të drejtësisë dhe sigurisë në vend kanë vlerësuar për gazetën "Epoka e re" se Kosova ende ka nevojë për këtë mision.
Profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka thënë për gazetën se edhe pas 14 qershorit prania e EULEX-it në Kosovë është e domosdoshme. "Duke pasur parasysh gjendjen që e kemi në sistemin e drejtësisë, po ashtu duke pasur parasysh se ende nuk është krijuar në një atmosferë të volitshme që të ndërtohet sintagma 'askush mbi ligjin', si dhe duke pasur parasysh se ekzistojnë një grup njerëzish të fortë me pushtet dhe para, mendoj se është e domosdoshme edhe për një kohë prania e EULEX-it në Kosovë qoftë drejtpërdrejt me lëndë apo si këshilltarë e mbështetës", është shprehur Salihu.
Edhe njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë për gazetën "Epoka e re", se duke pasur për bazë brishtësinë me të cilën po ballafaqohet sistemi juridik i Kosovës, edhe më tutje ka nevojë për kuadrin juridik evropian, por në një formë tjetër. "EULEX-i ka kryer disa detyra, por jo aq sa kemi pritur për sundim të ligjit në Kosovë. Janë evidentuar disa dobësi të këtij misioni. Është përfolur edhe çështja e korrupsionit dhe nepotizmit në mesin e këtij misioni. Pavarësisht prej kësaj, mendoj se ekspertët juridikë dhe politikanët tanë duhet ta diskutojnë çështjen e pranisë së mëtejmë të EULEX-it. Sidoqoftë, një prani, por jo në këtë formë të kuadrit juridik evropian, duhet të ekzistojë edhe më tej në Kosovë, duke pasur për bazë brishtësinë me të cilën po ballafaqohet sistemi ynë juridik. Për formën organizative dhe të tjera duhet të vendoset pas konsultave me ekspertët", ka deklaruar Qehaja.
Mandati i misionit të EULEX-it skadon më 15 qershor 2018, kurse misioni i ardhshëm do të jetë i përqendruar në përmbylljen e transferimit të plotë të kompetencave tek organet e Kosovës, si dhe në përmbylljen e misionit.

# Kuvendi nuk e miraton kërkesën e Vetëvendosjes për shkarkimin e Dërgutit



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Lëvizja Vetëvendosje nuk ka arritur të sigurojë të hënën mbështetjen e Kuvendit të Kosovës për shkarkimin e deputetes Aida Dërguti nga posti i nënkryetares së Kuvendit.
Nisma e Vetëvendosjes për shkarkimin e Dërgutit nga ky post ka pasuar ndarjen e kësaj partie politike që ndodhi kohë më parë. Gjatë fillimit të mandatit të kësaj legjislature, Dërguti ishte zgjedhur nënkryetare e Kuvendit si deputete e Vetëvendosjes. Ndërkaq, pas ndarjes së partisë, Dërguti tani i përket Partisë Social Demokrate, e cila është formuar nga fraksioni i Vetëvendosjes.
Nismën për shkarkimin e Dërgutit e kishte prezantuar deputeti i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, ndërkaq këtë nismë e ka kundërshtuar deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj. Sipas versionit të paraqitur nga Konjufca, posti i nënkryetarit në këtë rast i takon pikërisht Vetëvendosjes dhe jo PSD-së.
Rezultati i votimit ishte ky: 16 ishin për, 26 kundër dhe 48 abstenuan.
Kryesia e Kuvendit ka në përbërje kryetarin e Kuvendit si dhe pesë nënkryetarë të cilët vijnë nga tri grupet më të mëdha parlamentare të shumicës si dhe dy nënkryetarë nga komunitetet pakicë.

Flet për "Epokën e re", Bajram Hasani

# Zonat ekonomike mundësojnë zh

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka thënë se vendi ynë ka pasur nevojë për krijimin e zonave ekonomike, të cilat do të bëjnë të mundur zhvillim më të madh të bizneseve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hasani ka thënë se MTI-ja ka ndërmarrë shumë hapa për mbrojtjen e prodhuesve vendorë. Ai ka paralajmëruar se në cilëndo fushëveprimtari që prodhuesit ankohen se po dëmtohen nga importi, MTI-ja do të ndërmarrë masa për mbrojtjen e tyre. Hasani ka bërë me dije se MTI-ja ka nisur reformën për ristrukturimin e inspektorateve në nivel vendi, e cila në fund do të rezultojë me mënyrën më të mirë të funksionimit të tregut dhe garantimit të standardeve. Duke folur për bashkëpunimin Kosovë - Shqipëri, ai ka thënë se ka rritje të shkëmbimit tregtar, po prapëseprapë mbetet ende i ulët



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 QERSHOR -

**"Epoka e re":** *Z. Hasani, cilat janë pritjet e juaja sa i përket funksionimit të zonave ekonomike?*

**Hasani:** Vendi ynë ka pasur nevojë për krijimin e zonave ekonomike. Mendoj se përmes krijimit të zonave ekonomike do të bëjmë të mundur zhvillim më të madh të bizneseve vendore. Tashmë siç jeni edhe të njoftuar, kemi marrë vendim për krijimin e zonës ekonomike në Vushtrri. Kemi paralajmëruar edhe krijimin e zonave ekonomike në Prizren dhe Malishevë, si dhe vazhdimin e investimit në Zonën Ekonomike në Viti dhe Suharekë.

Që prej ardhjes sime në krye të MTI-së vazhdimisht jam në kontakt me bizneset anembanë vendit dhe në bisedat me tregtarët kemi parë se në këto vende janë shumë të nevojshme zonat ekonomike. Duke themeluar këto zona do të bëjmë lehtësime në punën dhe veprimtarinë e bizneseve të vendeve përkatëse. Bizneset tona kanë nevojë për stimulime e mbështetje. Duke i mbështetur bizneset, ne mundësojmë edhe krijimin e vendeve të reja të punës që janë mbase të nevojshme për qytetarët tanë. Në vazhdimësi do të ndihmojmë biznesin vendor, pasi vetëm kështu mund të arrijmë një zhvillim më të mirë ekonomik, zbutje të varfërisë dhe krijim të mirëqenies për qytetarët tanë.

**"Epoka e re":** *Keni thënë se viti 2018 do të jetë vit i investimeve. Sipas jush, në cilët sektorë pritet të kemi investime?*

**Hasani:** Ligji për investime strategjike hap një perspektivë të re për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe është një mundësi e mirë për vendin tonë. Ka shumë mundësi në sektorë të ndryshëm për të investuar në Kosovë. Ne shpresojmë se me këtë ligj po u krijojmë mundësi investitorëve të interesuar të investojnë në Kosovë dhe kështu të arrijmë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Jemi duke i parë mundësitë që projektet e tilla të sjellin sa më shumë mundësi punësimi. Tashmë ne vetëm se i kemi aplikuesit e parë dhe jemi duke punuar që të tërheqim sa më shumë investitorë strategjikë.

**"Epoka e re":** *Meqë jemi në sezonin veror, a keni marrë ndonjë kërkesë për mbrojtje të prodhuesve vendorë dhe a pritet të kemi sajim të problemeve, sidomos me Shqipërinë, sa iu përket prodhuesve të patates dhe verërave?*

**Hasani:** Ne deri më tani kemi marrë shumë hapa në drejtim të mbrojtjes së prodhuesve vendorë. Kemi marrë vendim për miellin, blloqet dhe qumështin. E kam thënë edhe herëve të tjera, se në cilëndo fushëveprimtari që prodhuesit ankohen se po dëmtohen nga importi dhe arrijmë në përfundim se ata po dëmtohen, do të ndërmarrim masa për mbrojtjen e tyre, pavarësisht nëse është Shqipëria apo cilido vend tjetër. Për mua si ministër i Tregtisë dhe Industrisë në rend të parë është mbështetja e prodhuesve tanë. Ky është prioriteti gjatë mandatit tim. Gjithashtu, kemi qenë mjaft të zëshëm në drejtim të institucioneve të Shqipërisë dhe disa herë kemi kërkuar nga to që të gjitha barrierat që po i hasin prodhuesit tanë për të eksportuar në Shqipëri të eliminohen. Disa herë u kemi dërguar shkesa institucioneve shqiptare, me qëllim që të hiqen të gjitha barrierat tarifore dhe jotarifore. Presim që institucionet e shtetit shqiptar të reflektojnë.

**"Epoka e re":** *Në Kuvendin e Kosovës u propozua rezoluta për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-dalje të shtetasve të Kosovës dhe Shqipërisë nëpërmjet pikave kufitare Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë. Sipas jush, sa do t'i ndihmonte kjo lehtësimit të shkëmbimeve tregtare në mes të dy shteteve?*

**Hasani:** Para disa javësh kemi mbajtur një konferencë të përbashkët në mes të Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë dhe Forumit Ekonomik të Prodhuesve Kombëtarë Shqiptarë, në të cilën kemi diskutuar për heqjen e barrierave tarifore dhe jotarifore, për qarkullimin e lirë tregtar dhe ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. I kemi identifikuar problematikat që prodhuesit kombëtarë të dy shteteve hasin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Tashmë ka një rritje të shkëmbimit tregtar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Kosova ka 50 milionë euro eksport në Shqipëri por, krahasuar me potencialin tonë, ky është një volum ende i ulët. Po ashtu, besoj se do të hasim në gatishmërinë e shtetit shqiptar për implementimin e marrëveshjeve që kemi në mes të dy vendeve që të krijojmë një klimë të përshtatshme për të bërit biznes për të dy vendet. Mbështetja ime institucionale si ministër i MTI-së nuk do të mungojë asnjëherë për prodhuesit e të dy vendeve. Për më tepër është detyrë e jona, edhe e Qeverisë së Shqipërisë, që ta mbështesim krijimin e një partneriteti të fuqishëm të bizneseve. Ne jemi duke punuar shumë si ministri që produktet të jenë sa më cilësore edhe për tregun evropian.

**"Epoka e re":** *Debalanci tregtar si dhe diferenca e madhe në mes të sektorit të tregtisë dhe prodhimit mbetën evidente. Çfarë mundë të presim gjatë mandatit tuaj në këtë drejtim dhe si e shihni bashkëpunimin tregtar të Kosovës me rajonin?*

**Hasani:** Jemi të vetëdijshëm që kemi disbalancë tregtare, por jemi duke punuar shumë për krijimin e një infrastrukture të cilësisë duke përfshirë, akreditimin, standardizim dhe metrologjinë, të cilat do të ndihmojnë drejtpërdrejt në rritjen e eksportit. Kemi shumë punë për të bërë që kompanitë tona të përgatiten për tregun e jashtëm. Në këtë aspekt ndihmë të madhe po na japin, sidomos në asistencë teknike, Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian.

**"Epoka e re":** *Mungesa e inspektorëve të mjaftueshëm po paraqet vështirësi. Çfarë numri inspektorësh duhet të kemi në mënyrë që të mbrohen të drejtat e konsumatorit?*

**Hasani:** Ne kemi nisur reformën

# villim më të madh të bizneseve



për ristrukturimin total të inspektorateve. Kemi kaluar koncept-dokumentin për reformën e thellë në inspektorate. Sipas të dhënave tona, në gjithë vendin, si në nivelin lokal dhe atë qendror, veprojnë 42 inspektorate. Po synojmë të tkurren dhe të bëhen vetëm 15-16 inspektorate. Tani e kemi formuar një grup punues në të cilin janë të përfshira të gjitha palët e interesit sepse ky reformim i inspektoratit duhet të bëhet në bashkëpunim në mes të gjithë aktorëve. Nga analizat e bëra është vërejtur se problemin më të madh deri më tani e ka shkaktuar moskoordinimi i inspektorateve, mirëpo mund të themi se pas reformimit do të ketë koordinim më të mirë. Banka Botërore na ka rekomanduar të marrim si model Shqipërinë sepse reforma që është bërë atje ka rezultuar mjaft aktive. Reformimi i inspektorateve do të mundësojë një mënyrë më të mirë për funksionimin e tregut dhe garantimin e standardeve. Kjo reformë është e domosdoshëm për ta luftuar arbitraritetin dhe çdo praktikë abuzive, e cila dëmton në mënyrë ta pameritual biznesin dhe zhvillimin e tij. MTI-ja si bartëse e këtij reformimi do të jetë shumë e kujdesshëm për implementimin me saktësi e vendosmëri të reformës së inspektimit.

**"Epoka e re":** *Ministër, MTI-ja është udhëheqës e Task Forcës për të bërit biznes. Çfarë keni bërë deri më tani për krijimin e një klime më të mirë për të bërë biznes?*

**Hasani:** Si rezultat i Task Forcës janë bërë një seri përmirësimesh në fushën e të bërit biznes, ku Kosova është renditur në vendin e 40 në listën e Bankës Botërore. Progresi në fushën e të bërit biznes është një angazhim i përbashkët i të gjitha ministrive të linjave, por edhe të gjitha institucioneve tjera dhe kjo ka reflektuar në raportet e fundit të Bankës Botërore, ku Kosova është renditur në pozitën e 40 në nivelin Botëror dhe presim këtë vit të kemi përparime në rangimin e të bërit biznes. Por, keni parasysh se përmirësimi i ambientit të biznesit s'mund të bëhet nga një ministri, apo institucion i vetëm, por bëhet vetëm duke u bashkuar dhe koordinuar përpjekjet tona që të largojmë çdo barrierë dhe të eliminojmë atë që quhet burokraci e që paraqet kosto të biznesit. Ne vazhdimisht jemi duke punuar në drejtim të promovimit të Kosovës si vend që ka krijuar dhe po krijon politika të favorshme të biznesit. Po ashtu, në Raportin e fundit të Progresit, 70-80 për qind e progresit të vlerësuar ka qenë nga puna e MTI-së.

**"Epoka e re":** *Një ndër takimet e zhvilluara së fundmi ka qenë me kryebashkiakun e Vlorës, Dritan Leli. Çfarë u pajtuat me të?*

**Hasani:** Gjatë këtij takimi kam kërkuar nga kryebashkiaku Leli të organizohen vizita të nxënësve nga Vlora në Kosovë, me qëllim që të zhvillohet turizmi. Nxënësit tanë çdo vit e vizitojnë Shqipërinë. Pse mos të ketë edhe organizime nga Shqipëria në Kosovë. Kjo ide u mirëprit nga kryebashkiaku Leli. Po mendojmë që nga ky vit do të bëhen organizime të tilla nga Shqipëria në Kosovë. Mendoj se të dy vendet kemi çfarë i ofrojmë njëri-tjetrit në fushën e turizmit. Ata e kanë bregdetin, por edhe ne kemi shumë zona turistike.

**"Epoka e re":** *Veç angazhimeve në ministri, ju kemi parë shumë aktiv edhe në aktivitete partiake në Gjilan. Si po ju shkon ky proces?*

**Hasani:** Përveç punëve të përditshme në ministri, pas orarit të punës kam vazhduar aktivitetet partiake për rritjen dhe konsolidimin e degës së Gjilanit, kryetar i së cilës jam. Jo vetëm Gjilani, por e tërë Nisma Socialdemokrate është duke punuar vazhdimisht për rritjen e partisë dhe ristrukturimin e saj. Deri më tani në Gjilan, bashkë me kryesinë dhe anëtarësinë e gjerë, jemi angazhuar të krijojmë nëndegët tona në secilën lagje dhe fshat të qytetit. Po ashtu, kemi zgjedhur edhe kryetarët e këtyre nëndegëve dhe kryesitë. Vullneti i jashtëzakonshëm i të rinjve dhe të rejave për të qenë pjesë e familjes sonë të madhe socialdemokrate po më motivon të punoj edhe më shumë. Kemi pasur shumë aderime të reja dhe dalëngadalë Nisma në Gjilan po bëhet një prej partive kryesore.

# Haradinaj: Kosova, e vendosur t'i parandalojë ideologjitë ekstremiste



Tiranë, 4 qershor - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se institucionet e Kosovës janë të vendosura të parandalojnë çdo përhapje të ideologjive ekstremiste që kanë potencial të kalojnë në terrorizëm.

Haradinaj i bëri këto komente në Konferencën për Sigurinë Globale që po mbahet në Tiranë. Haradinaj ka folur edhe rreth rolit konstruktiv dhe kontributit të Republikës së Kosovës në bashkëpunimet rajonale dhe më gjerë, në funksion të krijimit të paqes dhe stabilitetit.

Kryeministri ka thënë se komunitetet fetare dhe udhëheqësit fetarë do të vazhdojnë të jenë një nga partnerët më të rëndësishëm në luftën kundër mesazheve të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm. "Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi janë dukuri të cilat nuk e kanë një atdhe, nuk e kanë një lokacion të caktuar, por paraqesin rrezik për botën bashkëkohore, për njerëzimin, për paqen, sidomos për njerëzit e pafajshëm", ka thënë Haradinaj.

# Presidenti duhet ta udhëheq dialogun



Sali BILSIMI

Hashim Thaçi, president i Republikës së Kosovës, pa dyshim se ka mandatin, besimin dhe legjitimitetin për t'i udhëhequr bisedimet me Serbinë, kur këto bisedime tashmë kanë hyrë në fazën finale dhe janë udhëhequr kryesisht nga presidenti Thaçi. Nuk shohim asnjë arsye që ai mos të jetë në krye të përgjegjësive shtetërore për të mbyllur këtë kapitull të vështirë në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Kosova nuk ka kohë për të bërë eksperimente as fizkultura politike, në fakt liderët e tjerë kosovarë nuk e kanë as përvojën dhe as besimin për të drejtuar këtë proces final.
Pavarësia e Kosovës nuk është agjendë partiake dhe marketing personal apo partiak. Ajo është një e drejtë dhe fitore e dëshmuar e popullit të Kosovës dhe presidenti i Kosovës me Kushtetutë përfaqëson popullin e Kosovës. Ai, pra, gëzon besimin për ta udhëhequr këtë proces përfundimtar.
Propozimet e ndryshme për negociata nga liderë të tjerë në të vërtetë janë ide joserioze, delegjitime dhe mund ta rrënojnë tërë procesin për interesa partiake.
Andaj, ftoj deputetët e Parlamentin që kurdo që mbahet seanca për platformën e dialogut me Serbinë, t'i japin mandatin presidentit për t'i udhëhequr bisedimet me Serbinë për t'i evituar vonesat e panevojshme si në rastin e demarkacionit.
Hashim Thaçi është autoritet i dëshmuar nga lufta, negociatat në Rambuje, paslufta dhe bisedimet e Vjenës. Ai ka besimin dhe mandatin për ta përmbyllur këtë temë e cila sjellë edhe njohjen e Republikës së Kosovës nga vetë Serbia.

(Autori është drejtor i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës")

# Nis studimi i fizibilitetit për ShSKUK-në

Projekti ka për qëllim ta vlerësojë gjendjen ekzistuese të infrastrukturës së pajisjeve mjekësore në kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor në Kosovë dhe nevojat për: Pajisje të reja; staf shtesë profesional; trajnime specifike të stafit për përdorimin e pajisjeve; mbështetje teknike dhe material shpenzues për pajisjet

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) ka nisur studimi i fizibilitetit për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), i cili do t'i hapë rrugë projektit prej 50 milionë eurosh për pajisje mjekësore. Brenda tetë muajve ekipi i ekspertëve nga Evropa që ka ardhur në Kosovë do ta bëjë gati dokumentin strategjik, në bazë të të cilit do të orientohen investimet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme si pjesë e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
Projekti i studimit të fizibilitetit, i financuar nga "Western Balkans Investment Framework", do të realizohet përmes asistencës teknike të WBIF-IPF 6 me përkrahje të Bankës Evropiane për Investime.
Projekti ka për qëllim ta vlerësojë gjendjen ekzistuese të infrastrukturës së pajisjeve mjekësore në kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor në Kosovë dhe nevojat për: Pajisje të reja; staf shtesë profesional; trajnime specifike të stafit për përdorimin e pajisjeve; mbështetje teknike dhe material shpenzues për pajisjet.
Projekti do të zgjasë tetë muaj dhe në fund të tij ekspertët ndërkombëtarë, në bashkëpunim me stafin vendor profesional, do ta prezantojnë listën e pajisjeve të duhura mjekësore me specifika teknike si dhe rekomandimet për stafin dhe trajnimet e duhura për t'i përdorur pajisjet mjekësore.
Ky studim do ta tregojë gjendjen reale ekzistuese dhe do ta mundësojë aplikimin për fonde për t'i siguruar pajisjet e duhura mjekësore.
Studimet e tilla të mbështetura në dëshmi, nën ombrellën e Ministrisë së Shëndetësisë, janë e vetmja mënyrë për t'i pasqyruar nevojat reale të institucioneve tona shëndetësore.





# Thaçi i ndan medaljen presidenciale diplomatit Jeffrey Hovenier

Prishtinë, 4 qershor - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar të hënën diplomatin amerikan Jeffrey Hovenier, të cilin e ka dekoruar me Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë. "Mbështetja juaj dhe e ShBA-së në të gjitha proceset politike ka qenë përcaktuese për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Do të jemi përgjithmonë mirënjohës", ka thënë Thaçi. Ai e ka falënderuar diplomatin amerikan për, siç ka thënë, kontributin që ka dhënë në Konferencën e Rambujesë, në procesin e Vjenës dhe në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Diplomati amerikan Jeffrey Hovenier ka thënë se qëndrimi amerikan gjithmonë ka qenë në përkrahje të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. "Unë dhe familja ime ndihemi shumë të nderuar. Ndryshimet pozitive në Kosovë janë mbresëlënëse. Unë do të jem gjithmonë mik i Kosovës", është shprehur Hovenier.

## Testi i arritshmërisë këtë vit 61 për qind

PRISHTINË, 4 QERSHOR (ER) - Ministra e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka bërë publike rezultatet e Testit të Arritshmërisë për klasat e nënta, sipas të cilit, arritshmëria është 61 për qind, apo 3 për qind më shumë se në vitin e kaluar, ku arritshmëria ishte 58 për qind. Siç dihet, Testi i Arritshmërisë nuk ka karakter eliminues për nxënësit, por rangimi i tyre, sipas rezultateve, do t'u shërbejë si përparësi për regjistrimin e tyre në shkollimin e mesëm të lartë. Menjëherë pas shpalljes së rezultateve, MAShT ka filluar shpërndarjen e tyre në drejtoritë komunale të arsimit. Ky test i shërben MAShT-it edhe për shqyrtimin apo përmirësimin e politikave arsimore, me synimin e përhershëm për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

# Opozita nuk do ta votojë platformën për dialogun me Serbinë




Dy partitë më të mëdha opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), kanë paralajmëruar se nuk do ta votojnë platformën për dialogun me Serbinë. Sipas tyre, platforma shtetërore për dialog, e prezantuar nga Qeveria në Kuvendin e Kosovës, është e dobët dhe joserioze. Përfaqësuesit e këtyre subjekteve e kanë quajtur gabim në hapa hartimin e kësaj platforme

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) të hënën nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se nuk do ta votojë platformën për dialogun me Serbinë, sipas së cilës, bartës i këtij procesi është presidenti Hashim Thaçi. Kjo parti e ka quajtur të dobët dhe joserioze platformën shtetërore për dialogun Kosovë - Serbi. Megjithatë, LDK-ja mbetet e përkushtuar për një proces dialogues serioz, konsensual dhe brenda kornizave kushtetuese të Republikës së Kosovës. "Platforma për dialog, e prezantuar në Kuvendin e Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës është dokument i përgatitur dobët, joserioz dhe me pretendime jokushtetuese. Rrjedhimisht, grupi parlamentar i LDK-së në Kuvendin e Kosovës nuk do ta votojë platformën në fjalë. LDK-ja mbetet e përkushtuar për një proces dialogues serioz, konsensual dhe brenda kornizave kushtetuese të Republikës së Kosovës. LDK-ja beson në vlerat e pazëvendësueshme të dialogut politik jo vetëm si një mjet për marrëveshje, por edhe si një qenësi e jetës politike", është thënë në deklaratën e LDK-së.

Edhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka paralajmëruar se nuk do t'i japë mbështetje platformës për dialog në Kuvendin e Kosovës. Lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë se kjo platformë është gabim në hapa. Sipas tij, nuk mund të shkohet më tutje në dialogun Kosovë - Serbi pa pasur një vlerësim paraprak për procesin e gjashtëvjeçarit. "Sa iu përket platformave që sjell Qeveria nuk do ta zgjas shumë, por vetëm do të them se është gabim në hapa. Ne nga Qeveria presim ta sjellë një dokument zyrtar shtetëror si vlerësim për dialogun gjashtëvjeçar. Nuk mund të vazhdohet me platforma pa vlerësuar si kemi ardhur deri këtu. Nëse është qeveri e re, pas zgjedhjeve të vitit 2017 atëherë do të duhej ta kishte një vlerësim për dialogun paraprak të cilin e quajnë herë teknik e herë politik, për ato 33 marrëveshje, pastaj të vazhdojmë tutje. Nuk mund të sjellim platforma pa një vlerësim paraprak. Pra, është një gabim në hapa. Nga Qeveria Haradinaj doemos duhet të ketë një vlerësim për dialogun 2011-2017 që mban emrin e Hashim Thaçit dhe Edita Tahirit", ka deklaruar Kurti në një konferencë me gazetarë. Ndërsa subjekti tjetër opozitar, Partia Socialdemokrate (PSD), ende nuk e ka bërë publik qëndrimin përfundimtar lidhur me platformën për dialog.

Zëdhënësi i kësaj partie, Shkodran Hoti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se qëndrimi i PSD-së për platformën e dialogut do të bëhet publik shumë shpejt përmes një konferencë për media apo përmes një komunikate. Vendimi i LDK-së për të mos e votuar platformën shtetërore të dialogut është komentuar të hënën nga drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu.

Ai ka thënë se deklarata e LDK-së është kundër reagimit ndaj presionit publik sepse, sipas tij, deklarata e kësaj partie nuk e mohon përfshirjen në një konsensus, por kërkon një platformë konsensuale. "Deklarata e LDK-së është reagim kundër ndaj presionit publik. Përndryshe, kjo deklaratë s'e mohon përfshirjen në një konsensus, por kërkon një platformë konsensuale, e cila do të ishte me më vlerë institucionale nëse arrihet përmes debatit parlamentar, e jo takimeve që anashkalojnë debatin parlamentar", ka shkruar Kryeziu në llogarinë e vet në "Facebook".

Projekt-platforma shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve ka qenë pikë e rendit të ditës në seancën e së hënës për t'u diskutuar, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur për shkak të numrit të madh të çështjeve që janë debatuar. Platforma synon arritjen e marrëveshjes ligjërisht të obligueshme për të dyja palët, që nënkupton njohjen e ndërsjellët në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo platformë parasheh edhe krijimin e një mekanizmi të krijuar nga Kuvendi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog, por që procesi i dialogut do të udhëhiqet nga presidenti Hashim Thaçi. Synim kryesor i kësaj platformë është arritja e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut me Serbinë.



## Babai i Afrim Zhitisë viziton Veselin

PRISHTINË, 4 QERSHOR (ER) - Bacë Osman Zhitia, babai i heroit Afrim Zhitia, ka vizituar kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Kryeparlamentari në llogarinë se vet në "Facebook" ka shkruar se është befasuar nga kjo vizitë. "Një befasi e këndshme sot në zyrën time. Baca Osman, babai i heroit Afrim Zhitia, erdhi për vizitë dhe u kënaqëm muhabet", ka shkruar Veseli.

# Komuna e Rahovecit dhe Kolegji AAB fillojnë bashkëpunimin

RAHOVEC, 4 QERSHOR (ER) - Me qëllim të krijimit të mundësive të reja të bashkëpunimit në dobi të studentëve, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, dhe rektori i kolegjit AAB, Lulzim Tafa, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.
Përmes kësaj marrëveshje Komuna e Rahovecit dhe Kolegji AAB do të bashkëpunojnë për promovimin e arsimit cilësor nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta, si kryerjen e punës praktike për studentët e Kolegjit AAB në institucionet/departamentet, drejtoritë, agjencitë, institucionet shkollore dhe parashkollore të komunës, shkëmbimin e vizitave të organizuara tematike në dy drejtime nga nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit dhe bashkëpunim dhe fushata tematike ndërinstitucionale për të mirën e përgjithshme.
Gjithashtu, AAB do të ofrojë trajnime për stafin pedagogjik të shkollave varësisht nga kërkesa e komunës në fushën e pedagogjisë, metodologjisë së mësimdhënies, kurrikulës etj.






# Mjekë nga Amerika bënë kontrolle mjekësore falas për qytetarët e Mitrovicës

Mitrovicë, 4 qershor (ER) - Organizata joqeveritare "Kosovo Hope", në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi në Komunën e Mitrovicës, kanë organizuar të hënën vizita mjekësore me mjekë nga Amerika për qytetarët e Komunës së Mitrovicës. Këtë herë mjekët amerikanë vizitat i kanë bërë në Qendrën e Mjekësisë Familjare, në lagjen "Ilirida".
Para se të fillojnë vizitat mjekësore, mjekët amerikanë, në krye me drejtuesin e ekipit Mike Sorrels, i ka vizituar kryetari i komunës, Agim Bahtiri, bashkë me nënkryetarin Faruk Mujka dhe drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë, Ersekë Hasanaj. Bahtiri ka përshëndetur praninë e mjekëve amerikanë në Mitrovicë dhe i ka falënderuar për gatishmërinë e tyre që ta ofrojnë përvojën dhe shërbimet e tyre për pacientët e komunës. Ai ka thënë se Mitrovica dhe Kosova gjithmonë e kanë pasur mbështetjen e pakursyer nga Amerika, për çfarë edhe shqiptarët i janë mirënjohës përjetë.
Drejtori i OJQ "Kosovo Hope", Berat Gegaj, organizator i vizitës, ka thënë se qytetarët e Mitrovicës do të përfitojnë nga këto vizita, pasi mjekët amerikanë si ekspertë të dalluar do ta ofrojnë përvojën e tyre dhe do t'i këshillojnë pacientët për t'i tejkaluar problemet shëndetësore që kanë. Po ashtu, ai i ka njoftuar se mjekët amerikanë do të shpërndajnë barna falas për pacientët që do t'i kontrollojnë.

# Edhe Gjykata e Apelit hedh poshtë aktakuzën ndaj Ragip Begajt



MALISHEVË, 4 QERSHOR (ER) - Gjykata e Apelit e Kosovës ka refuzuar ankesën e Prokurorisë Speciale ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë të datës 3 prill të këtij viti kundër kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj.
Me anë të këtij aktvendimi Gjykata Themelore e ka hedhur poshtë aktakuzën e Prokurorisë dhe e ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit Ragip Begaj, për shkak të veprës penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", vepër të cilën dyshohet ta ketë kryer në cilësi të kryetarit të Komunës së Malishevës.
Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të Prokurorisë nuk janë të bazuara, ngaqë gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka marrën aktvendim për hedhje të aktakuzës dhe se arsyet e dhëna për mungesën e provave i aprovon edhe kjo gjykatë.

# Takohen Gashi e Ahmeti, flasin për projekte të përbashkëta



OBILIQ, 4 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, është takuar me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, me të cilin ka biseduar për disa projekte që kanë të bëjnë me dy komunat respektive.
Fillimisht Gashi e ka uruar Ahmetin për hyrjen në fuqi të Ligjit për Prishtinën.
Më tutje, Gashi e Ahmeti janë pajtuar ta bëjnë përgatitjen e projektit për rrugën dhe kolektorin Shkabaj-Kastriot, në mënyrë që të nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit.
Po ashtu, ata kanë diskutuar shumë çështje me rëndësi që u atakojnë të dy komunave.

# Sot hapet Panairi i Librit në Prishtinë




PRISHTINË, 4 QERSHOR - Sot (e martë), më 5 qershor, në Prishtinë, në orën 18:00, hapet edicioni i 20 jubilar i Panairit të Librit. Panairi do të mbahet në ambientet e Pallatit të Rinisë në kryeqytet dhe organizohet nga Shoqata e Botuesve të Kosovës. Sivjet pritet që në këtë panair të marrin pjesë rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Diaspora, ndërsa numri i titujve të rinj sillet rreth 1400-1500. Panairi i librit do të mbyllet më 10 qershor në orën 18:00.

# KOSID-i: Fokusi në qymyr, barrierë për tranzicionin e energjisë në Kosovë




EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Në kuadër të Javës për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë, Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) ka organizuar konferencën me temë "Tranzicioni i energjisë në Kosovë", në të cilën është shtjelluar rreth sistemit të energjisë në Kosovë, synimit drejt një zhvillimi të qëndrueshëm duke rritur përfshirjen e energjisë së ripertërishme dhe përmirësimin e efiçiencës së energjisë.
Konferenca u nda në dy panele diskutuese, ku me aktorët relevantë, vendorë e ndërkombëtarë, u diskutua rreth potencialit, sfidave dhe përfitimeve nga maksimizimi i efiçencës së energjisë dhe energjisë nga burimet e ripërtëritshme.
Përgjatë diskutimeve u theksua se Kosova duhet të fokusohet në investime në efiçiencën e energjisë si burim shtesë i energjisë, për promovimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe për agjendën evropiane të integrimit. Tutje, sipas panelistëve, energjia e ripërtëritshme dhe efiçienca e energjisë ofron mundësi konkrete të cilën Kosova duhet përcjellë për zgjidhjen e barrierave në sektorin e energjisë.
Gjithashtu, u përmend nevoja për ofrimin e mundësive dhe prioritizimin e burimeve të energjisë në agjendën e zhvillimit të energjisë në vend, ku u tha se investimet në BRE dhe EE do të gjenerojnë kursime të vërtetueshme të shpenzimeve për energji dhe do të ofrojnë përfitime të shumta sociale, ekonomike e mjedisore. Po ashtu, u diskutua rreth politikave mbi promovimin e efiçiencës dhe burimeve të ripërtrishme si instrumente në tranzicionin energjetik dhe se institucionet vendore duhet ta shohin këtë proces si të domosdoshëm për stabilizimin e sektorit të energjisë në vend.
Fokus mori edhe rëndësia e krijimit të Fondit për Efiçiencë të Energjisë, përcaktimi i caqeve të efiçiencës së energjisë dhe arritjen e tyre, zhvillimi i tregut të shërbimeve energjetike dhe masat e tjera të efiçiencës së energjisë.
Tema e panelit u diskutua edhe nga aspekti akademik, ku u theksua se është më se e rëndësishme investimi në shkencë dhe inovacion, edukimi i gjeneratave të reja dhe shtimi i rolit që arsimi ka në këtë proces.

## Rishpallet konkursi për drejtor menaxhues në KEK

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Korporata Energjetike e Kosovës ka rishpallur më 1 qershor konkursin për pozitat drejtor menaxhues, drejtor ekzekutiv financiar dhe këshilltar i përgjithshëm/sekretar i korporatës. Për pozitën e drejtorit menaxhues kërkohet që kandidati të ketë së paku pesë vjet përvojë në nivel të menaxhmentit të lartë. Po ashtu, kërkohet të ketë diplomë universitare në lëmin e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë apo juridik. Gjithashtu, bëhet me dije se preferohen edhe individët me përvojë pune në ndërmarrjet e tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë.
Për herë të parë KEK-u ka shpallur konkurs për drejtor menaxhues më 5 prill.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik përmes një opinioni dërguar Bordit Drejtues (BD) të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ka kërkuar të rishqyrtohet vendimi për konkursin e shpallur më 4 dhe 5 prill për drejtor menaxhues, zyrtar të auditimit të brendshëm, drejtor ekzekutiv financiar dhe këshilltar i përgjithshëm/sekretar të KEK-ut.
MZhE-ja ka kërkuar që fillimisht t'u ndërpritet kontrata personave që janë nëpër këto pozita, pastaj të shpallet konkursi. "BD-ja të gjitha veprimet dhe vendimet duhet t'i bazojë në rregullimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin që rregullon veprimtarinë edhe funksionimin e NP-ve, duke pasur kujdes që të emëruarve paraprakisht u pushojnë të drejtat dhe detyrat nga puna dhe marrëdhënia e punës sipas vlerësimit dhe vendi të jetë i lirë e pastaj të veprohet sipas kërkesave për emërimin dhe zgjedhjen e zyrtarëve të lartë të rregulluar në ligjin për NP", është theksuar në opinionin drejtuar Bordit të KEK-ut nga MZhE-ja.
Konkursi i shpallur më 6 prill 2018 për pozitat drejtor menaxhues, drejtor ekzekutiv financiar dhe këshilltar i përgjithshëm/sekretar i korporatës është anuluar me vendim të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut më 23 maj 2018. Kurse, së fundi, në mbledhjen e Bordit Drejtues të KEK-ut, drejtori menaxhues i deritanishëm i KEK-ut, Arben Gjukaj, ka dhënë dorëheqje nga posti i tij. Menjëherë pas dorëheqjes së Gjukajt, Njazi Thaçi është emëruar ushtrues detyre i drejtorit menaxhues në KEK.
Konkursi për pozitat e shpallura në KEK është i hapur deri më 2 korrik 2018.

# Hamza: Gjermania, partnere strategjike e Kosovës



PRISHTINË, 4 QERSHOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, me të cilin ka diskutuar për progresin të cilin e ka arritur Kosova gjatë këtyre muajve në fushën e financave.
Hamza ka falënderuar ambasadorin gjerman Christian Heldt dhe shtetin gjerman, si partner strategjik i Kosovës, për ndihmën që vazhdon të japë për Ministrinë e Financave dhe agjencitë e saj.
Me këtë rast, Hamza e ka njoftuar ambasadorin gjerman për progresin dhe të arriturat në Ministrinë e Financave për trendin pozitiv të të hyrave gjatë këtij gjashtëmujori për nivelin e shpenzimeve buxhetore si dhe për stabilitetin makro fiskal në përgjithësi.
Po ashtu, Hamza e ka njoftuar ambasadorin Heldt për reformat në legjislacionin tatimor dhe planet e Ministrisë së Financave për reformat në politikat fiskale, në të mirë të të bërit biznes në Kosovë.
Ndërsa ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka shprehur gatishmërinë e shtetit gjerman për vazhdimin e bashkëpunimit dhe ofrimin e ndihmës për Kosovën për realizimin e planeve strategjike në fushën e financave.

Analizë e KMDLNj-së

# A KA PAJTIM ME SERBINË DHE K

**Nuk ka përfunduar ende spiralja e dhunës:** Kohët e fundit është një përndezje emocionale, spekulative dhe politike e disa liderëve kosovarë që, duke menduar se do të bëhen pjesë e historisë, ata do të jenë bartës dhe finalizues të pajtimit me Serbinë e cila, për më shumë se 100 vjet, i shtypi shqiptarët, deri në gjenocid, sikur që ishte lufta e fundit e viteve 1997-1999 në Kosovë. Ideja e pajtimit me Serbinë nuk është e ditëve tona, por u aktualizua menjëherë pas përfundimit të luftës sipas parimit: "Ta rrahim hekurin sa është i nxehtë" dhe këtë rol e mori ish-kryeadministatori i Kosovës, Bernard Kushner, ndërkaq njeriun kyç që do ta zbatonte këtë proces nga ana kosovare e gjeti në personalitetin karizmatik dhe autoritetin e pakontestueshëm moral dhe kombëtar, z. Adem Demaçi, me të cilin, në zyrat e KMDLNj-së pati disa takime. Z. Kushner ishte praktik dhe pragmatik, dinak dhe insistues sikur që shërbente si katalizator i këtij procesi duke menduar se Adem Demaçi do ta pranonte çdo kusht nga z. Kushner e këto kushte ishin kryesisht në linjën e interesave të Serbisë. Për model ishte marrë rasti i Afrikës së Jugut ndonëse kishte dallime përmbajtjesore dhe të papajtueshme midis këtyre dy rasteve, Afrikës së Jugut apo Mendeles dhe W. de Klerk dhe udhëheqësve të përkohshëm kosovarë dhe regjimit në Serbi i cili vendnumëronte duke mos treguar fare vullnet dhe gatishmëri që, përmes kërkimfaljes, si veprim simbolik dhe moral, ta hapë rrugën për procesin e pajtimit i cili, për të painformuarit zgjatë shumë gjatë dhe është jashtëzakonisht i ndërlikuar. Për dallim nga Kosova, në Afrikën e Jugut, Nelson Mendela, si udhëheqës shpirtëror dhe politik i atyre që luftuan dhe e fituan luftën, përveç autoritetit të pakundërshtueshëm, ishte i veshur edhe me fuqi politike e që nënkuptonte se vendimmarrja për ecurinë e këtij procesi, suksesit apo dështimit ishte te vet Mendela. Williem de Klerk, si udhëheqës i palës që për më shumë se 250 vjet e mbajti si koloni Afrikën e Jugut, edhe pas humbjes së luftës ishte forcë që duhet të pyetej për përfundimin e bisedimeve dhe fatin e procesit të pajtimit. Ishte qëndrim i përbashkët se marrëveshja për paqe, përmes normalizimit të marrëdhënieve pashmangshëm duhet të ndodhë se ishte përgjegjësi e dy palëve, më shumë e palës fituese e cila duhej ta pengonte hakmarrjen ndaj të bardhëve që kishin bërë krime të shumta të luftës. Ishte një problem se në çështjen e ballafaqimit me të kaluarën, si kusht i domosdoshëm për normalizim dhe pajtim, ishin dy pozicione krejtësisht të kundërta dhe përjashtuese; Mendela kërkonte të hetohen dhe gjykohen të gjithë ata që kishin kryer krime, përfshirë këtu edhe de Klerkun, ndërkaq pala kolonizuese për më shumë se 250 vjet kërkonte që të mos dënohej asnjë individ nga ana e kolonizuesve. Në këtë situatë duhej një autoritet moral që do të pranohej nga të dyja palët si dhe ndërmjetësuesit dhe kjo figurë u gjet në personalitetin e peshkopit Desmond Tutu që luajti rol vendimtar në këtë proces. Dhe procesi vazhdoi për të mos përfunduar krejtësisht as sot.

Adem Demaçi kishte kushte, krejtësisht normale kundrejt ato të Kushnerit që ishin në linjën e Serbisë: Pas disa takimeve në zyrat e KMDLNj-së, Adem Demaçi, i parashtroi disa kushte që do të duhej të plotësoheshin nga Serbia për të vazhduar më tej; kërkimfalja e Serbisë për krimet në Kosovë, lirimi i të gjithë të burgosurve, pengjeve të luftës që ishin në burgjet e Serbisë, zbardhja e fatit për personat e zhdukur, zbulimi i lokacioneve të varrezave masive, zbulimi i vendeve të minuara e që merrnin shumë jeta në Kosovë, dorëzimi dhe gjykimi i të dyshuarve për krime lufte në Kosovë, kompensimi i dëmeve materiale që kishte bërë Serbia në Kosovë, kthimi i mjeteve nga fondi pensional dhe kursimet e qytetarëve të Kosovës e që ishin në bankat e Serbisë, kthimi i arkivave dhe artefakteve kulturore, hisja e Kosovës në ndarjen e pasurisë sikur që e fituan të gjitha republikat dhe mosndërhyrja e Serbisë në punët e brendshme të Kosovës. Sigurisht, pas konsultimeve, z. Kushner i tha Adem Demaçit se kushtet e parashtruara nga ana e z. Demaçi ishin krejtësisht të papranueshme për Serbinë, prandaj as që mund të diskutohet për to. Adem Demaçi atëherë u përgjigj se pa plotësimin e këtyre kushteve as që do të bëhen përpjekje për normalizim të marrëdhënieve, ndërkaq për pajtim, në rrethanat ekzistuese, vetëm mund të imagjinohet dhe pasi nuk po i pranoni kushtet tona, atëherë shkoni dhe bisedoni me Serbinë. Serbia është shkaktare e luftës dhe gjenocidit në Kosovë, prandaj adresa e përgjegjësisë për këtë është e padiskutueshme. Pas kësaj nuk kishte më takime midis Adem Demaçit dhe kryeadministratorit të Kosovës, z. Bernard Kushner. Adem Demaçi nuk bëri lëshime që e dëmtonin Kosovën, prandaj ky proces u shua që në fillim.




Më vonë, presidenti i Serbisë, një ndër ideologët e krimit të Serbisë në Kosovë, Vojisllav Koshtunica, e bëri një komision shtetëror të Serbisë për pajtim e që ishte e qartë se e bëri për qëllime politike sepse kërkonte amnisti dhe pandëshkueshmëri për ata që bënë krime në Kosovë. Nga ana e Kosovës, në këtë proces të "pajtimit" parashiheshin personalitete që kurrë nuk kishin pasur problem e as pasoja nga Serbia, personalitete jo të besueshme, në çdo aspekt.

**Grupi Ndërministror për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim, fillimi politik dhe shuarja politike:** Me "përparimin" e bisedimeve "teknike" midis bashkësisë ndërkombëtare dhe Serbisë ku Kosova ishte pjesëmarrës pasiv dhe jondikues u riaktualizua procesi i ballafaqimit me të kaluarën dhe pajtim dhe për këtë u formua Grupi Punues për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim që përbëhej nga pjesa institucionale dhe shoqëria civile. Themelues ishte kryeministri i atëhershëm, z. Hashim Thaçi dhe drejtohej nga përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit. Ishte një dallim i madh sepse përfaqësuesit institucionalë nuk kishin njohuri për këtë proces, kurse shoqëria civile që kishte punuar një kohë të gjatë ishte njohëse e mirë e këtij procesi, prandaj ishte shpirti, zemra, mendja dhe truri i këtij procesi, por se nuk kishte fare përkrahje nga themeluesi dhe as nga ndërkombëtarët që kishin ndikim vendimtar. UNDP-ja, si mami e të gjitha proceseve në Kosovë, edhe aty ku nuk do të duhej të përfshihej fare, ishte lehtësues duke ofruar "ekspertizë profesionale" dhe përkrahje të vogël financiare, në ndërkohë që menaxhonte

# UR MUND TË NDODHË PAJTIMI?



fondet për këtë proces. Madje edhe ato të Kosovës. Shoqëria civile bëri punë të madhe dhe të mirë në këtë grup krejtësisht në baza vullnetare. Ishte e paracaktuar që ky grup të mos jetë funksional dhe me ndërrimin e Qeverisë, erdhi edhe drejtuesi i ri i këtij grupi i cili nuk ishte fare i familjarizuar me punën e grupit, duke e vazhduar projektin e dështimit. Ky grup u formua për qëllime politike dhe nevoja personale përkatësisht për nevoja fiziologjike - politike të Hashim Thaçit, ish-kryeministër për të vazhduar me Isa Mustafën i cili nuk kishte ide fare se ç'duhej bërë me këtë proces duke e trashëguar këtë nga ish-kryeministri. Ky grup, me kalimin e kohës, ra në koma dhe ishte buzë shuarjes e që u bë me vullnetin e themeluesit të parë, Hashim Thaçit, i cili, me përparimin e procesit të bisedimeve për "normalizim", doli me idenë për themelimin e një Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin, cili, sikur edhe grupi i mëparshëm, ishte dhe mbeti instrument politik dhe qëllimi është e kundërta e asaj që proklamohej. Lansimin e kësaj ideje e bëri me ndihmën e disa personaliteteve ndërkombëtare, hulumtues dhe përfitues të të mirave materiale. Edhe ky Komision, me emër të madh por me përmbajtje politike dhe mashtruese, ende pa u formuar po keqpërdoret për qëllime politike. Për formimin e këtij Komisioni (këtë ide e kishte edhe Kushneri domosdoshmërisht duhet të plotësohen disa parakushte e që, thuaja në asnjërën pikë nuk janë plotësuar, prandaj është iluzore të besohet se ky Komision mund të jetë i suksesshëm. Është formuar një grup teknik për draftimin e një infrastrukture ligjore për formimin, mandatin dhe afatizimin e punës së Komisionit, anëtarët e së cilës kanë rol ekskluzivisht teknik dhe se ata nuk do të kenë të drejtë të jenë anëtarë të ardhshëm të këtij Komisioni. Anëtarët e këtij grupi teknik nuk kanë nevojë t'i shpikin "rrezet e diellit", por vetëm duhet t'i modifikojnë ato që i ka finalizuar Grupi Ndërministror për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin. Edhe ky Komision do të jetë bisht i zgjatur i bisedimeve dhe vendimeve politike duke mos e përmbushur kërkesën dhe shpresën e viktimave për drejtësi, prandaj dështimin e ka të garantuar. Askush sot në Serbi e as në Kosovë, nga ata krerët e vendimmarrjes politike, nuk është i interesuar, as për normalizim e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, kurse për pajtim as që mund të paramendohet.

**Pajtimi si akt administrativ apo vullnet i palëve:** Nuk ka luftë që nuk ka fund sikur që nuk ka armiqësi të paskajshme. Nuk ka përparim pa normalizim të marrëdhënieve sikur që nuk ka qetësi dhe siguri, pa pajtim. Edhe shtetet që kanë bërë luftëra qindravjeçare u kanë dhënë fund armiqësive duke u shndërruar në aleatë. Shembull për këtë e kemi Francën dhe Gjermaninë. Nuk ka normalizim e as pajtim pa u ballafaquar me të kaluarën, pa u filtruar para drejtësisë, pa ndryshuar vetëdijen dhe pa u bindur se ky është vullnet i të dyja palëve. Dhe interes i të dyja palëve. Sigurisht se është i domosdoshëm kërkimfalja, si parakusht i suksesit të proceseve të tjera. Duhet të përmbushen katër shtyllat e drejtësisë transicionale nëse duam të shpresojmë se kemi hyrë në rrugë të mbarë, shumë të gjatë e që stacionin e fundit e ka pajtimin, si shprehje e vullnetit dhe domosdoshmërisë e jo si diktat i një marrëveshjeje të imponuar apo si akt administrativ. Është shumë e qartë se politikanët aktualë në Serbi dhe në Kosovë nuk mund ta arrijnë pajtimin, por se janë të detyruar të bisedojnë për normalizim të marrëdhënieve edhe përkundër dëshirës së tyre. Gjatë rrugës së gjatë të normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve dhe maratonës drejt pajtimit, nëse vërtet do të funksiononte Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin, shumë politikanë do të përfundonin në burg, të tjerët do të detyrohen, pas një kohe të caktuar, me "vetëdëshirë" të tërhiqen nga politika, kurse disa do t'i eliminojë biologjia dhe patologjia.

**Po ku jemi në këtë drejtim:** Në hapësirat e ish-Jugosllavisë ishte formuar një nismë për të vërtetën dhe pajtimin, një iniciativë rajonale e quajtur REKOM, apo aleancë trepalëshe Beograd - Sarajevë - Zagreb, ku Kosova llogaritej si pjesë e Serbisë e të cilën KMDLNj-ja e pati kundërshtuar dhe nuk ka pranuar të jetë pjesë e saj. Ky farë REKOM-i gjeti aleatë në Kosovë, ku për një grusht parash (shumica e parave shkonte në Beograd dhe Zagreb, kurse Sarajeva ishte diskriminuar, prandaj për një kohë u tërhoq nga ky bosht trepalësh) sikur që instrumentalizoi disa politikanë kosovarë që kishin traditë të bashkëpunimit në kohën e ish-Jugosllavisë. Ky farë REKOM-i, tash si fantazmë, ka lëshuar pipëzat edhe në grupin teknik sikur edhe, pa asnjë dyshim, mund dhe do të jetë në përbërje të këtij Komisioni e që do ta shndërronte procesin e pajtimit nga një akt i vullnetshëm, në një akt administrativ. Mund të pajtohet dhe mund të falë vetëm ai që ka pësuar, ata që nuk kanë pësuar vetëm mund të përfitojnë! Këtij procesi dhe në përbërje të këtij Komisioni mund të jenë autoritetet kombëtare dhe morale, që njerëzoren e kanë mbi interesat personale. Duhet të ndryshojë konteksti politik, mendor dhe kulturor në mënyrë që ky proces të përparojë. Në Serbi aktualisht nuk kemi asnjë ndryshim që do të kontribuonte në përmbushjen e shtyllave të drejtësisë transicionale, sidomos shtyllës së katërt për mospërsëritje të së kaluarës së dhunshme. Me ndërhyrje flagrante në punët e brendshme të Kosovës dhe me praninë e strukturave paralele të të gjitha lëmenjve e të sigurisë në veçanti, Serbia po dërgon porosi të qartë se nuk ka ndërmend ta përmbushë këtë shtyllë të katërt të drejtësisë tranzicionale, garancisë për mospërsëritje. Edhe në Kosovë ka politikanë që nuk duan të ballafaqohen me të kaluarën apo duan vetëm nëse një të kaluar inkriminuese ta shesin si vlerë demokratike dhe të pranuar si të tillë nga ndërkombëtarët. Nuk ka ballafaqim me të kaluarën kur e doni të kaluarën e palës kundërshtare si e kaluar kriminale, kurse të kaluarën tuaj si diçka patriotike! Nuk ka drejtësi për viktimat tuaja, kurse viktimat e palës tjetër i konsideroni si kriminelë, ende pa u përfunduar hetimet! Nuk ka drejtësi, as tradicionale e as tranzicionale, kur ata të palës tjetër, apriori cilësohen si kriminelë, kurse këta të palës suaj i cilësoni si patriotë, ndonëse natyra e krimeve të bëra nuk dallon aspak. Në Serbi nuk ka as autoritete morale; kisha ortodokse serbe është projektuese, bekuese dhe kupola e krimit ndaj shqiptarëve në Kosovë. Inteligjenca e Serbisë, e shpërfytyruar në Akademinë e Shkencave Serbe, është përpiluese e planeve dhe projekteve të krimeve në Kosovë. Mediet serbe kanë qenë frymëzuese dhe mbuluese të krimeve në Kosovë, kurse vetëm një pjesë e shoqërisë civile në Serbi kishte në angazhim kundër luftës në Kosovë. Sot në Serbi nuk ka autoritet moral, politik dhe kombëtar që do të distancohej nga e kaluara kriminale serbe në Kosovë e që do të kontribuonte në procesin e nisjes së një rrugëtimi të gjatë të pajtimit.

As në Kosovë nuk ka autoritete morale që do ta merrnin barrën e këtij procesi duke qenë i paanshëm dhe i drejtë. Autoritetet fetare janë manipuluar skajshmërisht, ose duke qenë pjesë aktive e krimit, ose duke u instrumentalizuar nga politika. Kisha ortodokse serbe ishte pjesë e krimit, kurse BIK-u është i instrumentalizuar nga politika. Kleri katolik në Kosovë është oportunist dhe përfitues i madh material, prandaj dhe sillet si i tillë. Në Kosovë nuk ka shoqëri civile apo individ në mesin e saj që e kanë guximin të përballen me këtë proces, pa u ndikuar nga politika apo të fortit.

Ndërkombëtarët në këtë proces janë krejtësisht hipokritë duke kërkuar drejtësi vetëm në baza etnike dhe duke viktimizuar përsëri viktimat për një përfitim politik apo për ndërtimin e një paqeje të imponuar. Shembull më të mirë e keni Gjykatën Speciale si shembull se si nuk do të duhej të shpaguheshin viktimat për vuajtjet e tyre sikur edhe se si nuk do të duhej të dënoheshin të dyshuarit për krime lufte, kësaj radhe në mënyrë selektive. Në këtë kontekst në Kosovë nuk mund të ketë pajtim të vullnetshëm, por pajtim me akte administrative, pa siguruar drejtësi për viktimat dhe pa siguruar përgjegjësi për ata që u provohet se kanë bërë krime, pavarësisht prej përkatësisë etnike, politike, statusit shoqëror, bindjeve fetare etj. Prandaj kemi situata kur nga pala serbe përmes kriminelëve të luftës si Sheshel, Vulin, Drecun, Odaloviq etj., nuk pranohen përpjekjet për pajtim nëse nuk e përjashtojnë Serbinë nga çdo përgjegjësi për këto krime apo situata kur kryeministri Haradinaj, sigurisht në mungesë të informatave për këtë proces, deklaron se do të pajtohemi me Serbinë në rast se Serbia e njeh pavarësinë e Kosovës duke neglizhuar faktin se njohja e pavarësisë është akt politik, kurse pajtimi është çështje e vullnetit të dyanshëm, sigurimit të drejtësisë për viktima dhe përgjegjësisë për shkelësit e së drejtës humanitare dhe se, në shumë raste njohja e pavarësisë nuk është kusht dhe nuk përfundon me pajtim. Edhe pas njohjes së pavarësisë, drejtësia duhet ta bëjë punën e saj, deri në mënjanimin e të gjithë faktorëve që kanë ndikuar për këtë tragjedi që ndodhi gjatë luftës së fundit në Kosovë. Përpjekje për riciklim të vëllazërim-bashkimit sipas "Mirëdita, Dobar dan" është e kundërta e asaj që kërkon një proces i mirëfilltë i normalizimit të marrëdhënieve, sidomos për pajtim të domosdoshëm, i cili nuk ka alternativë, por se mund të vonohet. Përfundimisht, këta politikanë, në Serbi dhe Kosovë, do të detyrohen ta nënshkruajnë një normalizim të imponuar, por se do të jenë dhe janë pengesë për një normalizim të dëshiruar, kurse duhet të jeni i çmendur krejtësisht dhe të besoni se këta mund tapërfundojnë procesin e pajtimit. Jam i sigurt se nuk janë të interesuar, as për normalizim të raporteve e lërë më për pajtim.

## Trumpi thotë se mund ta falë veten



UASHINGTON, 4 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se ai e ka të drejtën absolute për ta falur veten në hetimet për bashkëpunim të mundshëm të fshehtë midis fushatës së tij presidenciale me 2016 dhe Rusisë. "Siç është thënë nga studiues të shumtë ligjorë, unë e kam të drejtën absolute për ta falur veten, por pse do ta bëja një gjë të tillë kur nuk kam bërë asgjë të keqe?", shkroi Trumpi në "Twitter". Këshilltari i posaçëm, Robert Mueller, është duke hetuar qysh në maj të vitit të kaluar nëse Rusia ka ndërhyrë në zgjedhjet në ShBA, nëse ka pasur kontakte midis zyrtarëve rusë dhe fushatës së Trumpit dhe nëse ky i fundit ka penguar drejtësinë.
Trumpi, po ashtu, tha se emërimi i Muellerit ka qenë shkelje e Kushtetutës. "Emërimi i këshilltarit të posaçëm është krejtësisht jokushtetues. Pavarësisht kësaj, ne e luajmë lojën sepse, ndryshe nga demokratët, ne nuk kemi bërë asgjë të keqe", tha Trumpi.
Deklaratat e presidentit vijnë pasi një prej avokatëve të tij, Rudy Giuliani, ka thënë të dielën se presidenti "ndoshta" ka fuqi ta falë veten. Por, Giuliani ka paralajmëruar se një veprim i tillë do të kishte pasoja të vështira politike. Trumpi e ka mohuar vazhdimisht bashkëpunimin me Rusinë, ndërsa kjo e fundit ka mohuar çdo ndërhyrje.

# Vështirësi për formimin e koalicionit qeverisës në Slloveni

Partia Demokratike Sllovene SDS fitoi shumicën e vendeve në parlament, gjithsej 25, dhe ka nevojë për mbështetjen e së paku dy partive të tjera. Nën drejtimin e ish-kryeministrit slloven Janez Jansha dhe mbështetur nga kryeministri nacionalist i Hungarisë, Viktor Orban, kjo parti kundërshton ashpër planet e BE-së për të vendosur kuota për strehimin e azilkërkuesve në vendet anëtare



LUBJANË, 4 QERSHOR - Partia Demokratike e Sllovenisë (SDS), me prirje kundër emigrantëve, ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet parlamentare, duke reflektuar rigjallërimin e së djathtës ekstreme në shtetet e tjera të Evropës Lindore. Nisur nga qëndrimet e saj të një linje të ashpër mbi këtë çështje, kjo forcë politike pritet ta ketë të vështirë të formojë një koalicion qeverisës. Nëse SDS-ja nuk ia del të formojë një koalicion, shansi për ta formuar qeverinë do t'i jepet partisë që doli e dyta në garën zgjedhore, asaj të qendrës së majtë LMS.
Rezultatet e shpallura të dielën vonë në mbrëmje shpallën fituese të zgjedhjeve të përgjithshme partinë e qendrës së djathtë, që i bashkohet një vale që ka përfshirë disa vende anëtarë të BE-së, si Hungaria dhe Polonia, të cilat kundërshtojnë planet e BE-së për një sistem kuotash për azilkërkuesit.
Banorët e Lubjanës thonë se e kanë të vështirë të mendojnë se si mund të krijohet një koalicion i qëndrueshëm qeverisës kur zgjedhjet prodhuan një spektër të fragmentatizuar parlamentar. Disa madje thonë se e shohin si mision "të pamundur".
Gazeta ekonomike "Financa" doli të hënën me kryeartikullin "Kushdo që kërkon të qeverisë, së pari duhet të dijë të numërojë", duke iu referuar të nëntë partive që fituan vende në parlamentin slloven prej 90 anëtarësh.
Një banor i Lubjanës, i cili preferoi të identifikohet vetëm me emër, tha se kishte pritur diçka më të qëndrueshme. "Prisja diçka më të qëndrueshme! Nëntë parti në parlament mendoj se janë shumë. Partitë e vogla nuk na çojnë askund", thotë Martini, një banor i Lubjanës.
Një tjetër banore, tha se pret që Partia Demokratike e Sllovenisë, e cila fitoi numrin më të madh të votave, të hasë vështirësi për krijimin e një qeverie. Sipas saj, partia që doli e dyta në garën zgjedhore, ajo e Marjan Sarecit, ka shanse më të mira. "Mendoj se Marjan Sarec mund ta formojë qeverinë. Partia Demokratike e Sllovenisë do ta ketë të vështirë krijimin e një koalicioni por, mbetet të shihet", tha ajo.
Partia Demokratike Sllovene SDS fitoi shumicën e vendeve në parlament, gjithsejtë 25, dhe ka nevojë për mbështetjen e së paku dy partive të tjera.
Nën drejtimin e ish-kryeministrit slloven Janez Jansha dhe mbështetur nga kryeministri nacionalist i Hungarisë, Viktor Orban, kjo parti kundërshton ashpër planet e BE-së për të vendosur kuota për strehimin e azilkërkuesve në vendet anëtare. Sllovenia ndodhet në korridorin rrugor ballkanik i cili është përdorur nga shumë emigrantë të cilët i janë larguar varfërisë dhe luftës në Lindjen e Mesme dhe Afrikë. Këtë vit numri i emigrantëve që kanë kaluar nëpërmjet Sllovenisë drejt vendeve të tjera evropiane është rritur.
Partia e qendrës së majtë LMS u radhit e dyta me 12.6 për qind të votave ose 13 vende në parlament. Udhëheqësi i saj, Marjan Sarec, tha se pret t'i jepet një mundësi për ta formuar qeverinë, në kushtet kur, siç tha, shumica e partive e kishin bërë të ditur përpara zgjedhjeve, se kishin pak gjasa të bashkëpunonin me SDS-në.
Presidenti slloven Borut Pahor ka bërë me dije se pas zgjedhjeve ka në plan t'i japë shansin e parë për të formuar një qeveri, partisë që fiton shumicën e vendeve në parlament. Pjesëmarrja në votime ishte rreth 51.5 për qind krahasuar me 51.7 për qind katër vjet më parë.

## Putini fton Kim Jong Unin për vizitë në Rusi



MOSKË, 4 QERSHOR - Presidenti rus Vladimir Putin ka ftuar udhëheqësin koreanoverior Kim Jong Unin në Rusi, për të marrë pjesë në një forum global që mbahet në Rusi. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme ruse Dmitry Peskov u tha gazetarëve në Moskë, se presidenti Putin ia kishte çuar ftesën Kim Jong Unit përmes ministrit të Jashtëm rus Sergei Lavrov, gjatë vizitës së këtij të fundit në Phenian javën e kaluar.
Zëdhënësi rus tha se Putini e kishte ftuar udhëheqësin koreanoverior të merrte pjesë në Forumin Ekonomik të vendeve të Lindjes së Largët, që është në plan të mbahet në qytetin port Vladivostok në muajin shtator.

# Filialet e shërbimeve sekrete jugosllave në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame

*- Hoxhallarët komunistë marksistë-leninistë jugosllavë dhe nacionalistët shqiptarë*



Bardhyl MAHMUTI

Çdokush që ka lexuar memoaret e Sulejman Rexhepit, kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni, e ka të qartë se "hoxhallarët komunistë", të edukuar në frymën e "marksizëm-leninizmit jugosllav, ishin mishëruar me historinë e huaj". Është e kuptueshme se, si rezultat i këtij mishërimi, një numër teologësh myslimanë shqiptarë kishin "emocione të fuqishme sa trupin ua përshkonte një zjarr kur dikush i identifikonte me figurat historike sllave, si Gjorçe Petrovi". Është e kuptueshme se këta teologë të "marksizëm-leninizmit jugosllav" kurrë "nuk kanë ndjerë emocione më vonë, kur dikush i identifikonte me Skënderbeun". Prandaj është edhe më e kuptueshme se pjella e një edukimi të tillë ka si rezultat faktin që edhe sot e kësaj dite një numër teologësh marksistë-leninistë jugosllavë shajnë në mënyrën më të poshtër Skënderbeun, Nënë Terezën, Ismail Kadarenë dhe figura të tjera të historisë dhe kulturës kombëtare shqiptare.

***

Njerëzit që nuk i zotërojnë konceptet teorike për ta analizuar realitetin në dimensionin politik, kanë tendenca prirje ta personalizojnë politikën. Për këtë arsye, një nga shtyllat e orientimit metodologjik të politologëve konsiston në shmangien e kësaj qasjeje, që ka për prioritet sjelljen e njerëzve. Përkundër rëndësisë që ka edhe ky aspekt i problematikës, asnjëherë nuk jam ndalur në këtë çështje, sepse jam përpjekur t'i shqyrtoj ngjarjet në kontekstin global.

Në qindra shkrime të ndryshme nga qindra autorë është bërë denoncimi publik, se një numër hoxhallarësh kishin hyrë në shërbim të politikës së sllavëve të jugut që kishin pushtuar territoret shqiptare. Meqenëse po më shtrohet pyetja që të përmend emra konkretë të teologëve që u kanë shërbyer politikave anti-shqiptare, po sjell për lexuesin argumentet që kërkojnë teologët e llojit të Mustafa Bajramit.

Për të shmangur çdo lloj manipulimi lidhur me burimet e informatave, do të citoj pjesë nga memoaret e Sulejman Rexhepit, kryetarit aktual të Bashkësisë Fetare Islame (BFI) në Maqedoni. Sa i përket problematikës që po trajtoj, memoaret e këtij teologu islam janë më me peshë se të gjitha fjalët dhe argumentet që janë thënë deri tani. Është imami i parë shqiptar, që tregon haptazi se ka qenë spiun i Shërbimeve Sekrete Sllav, motivet që e kanë shtyrë të bashkëpunojë me UDB-në, kontekstet e bashkëpunimit, avancimin e tij deri në funksionin më të rëndësishëm në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni dhe përfshirjen e Filialeve të UDB-së në gjirin e Bashkësisë Fetare Islame.

Pjesët që do të citoj nga këto kujtime të Sulejman Rexhepit, do të tronditin të gjithë besimtarët myslimanë që nuk kanë pasur njohuri për këtë realitet të hidhur. Përkundër mendimeve personale që kam për këtë kategori teologësh myslimanë, memoaret e Sulejman Rexhepit janë ndër memoaret më interesante që kam lexuar ndonjëherë. Mendoj se asnjë shqiptar nuk duhet të mbetet pa i lexuar këto memoare, sepse janë dëshmi që sqarojnë shumë hamendësime. Po sqaroj lexuesin, se citatet që do të nxirren nga këto memoare do të renditen në përputhje me problematikën që po trajtoj e jo në bazë të numrave rendorë të kujtimeve të tij.

Fjalën e ka Sulejman Rexhepi:

"Miq të dashur! Vëllezër e motra! Para do kohe, një mikut tim të ngushtë ia dhashë dorëshkrimin tim me memoare për t'i lexuar dhe, eventualisht për t'i redaktuar, meqë është njeri i pendës. Ishshefit tim të kabinetit, H. Agron Vojnikës, i kisha thënë që do t'ia jepja këtë dorëshkrim me kusht që ta botonte pasi të bëhesha për rahmet. Por, meqë gabova dhe ia dhashë mikut për t'i lexuar, megjithatë, është kohë e turbullt, kohë kur nuk mund t'i besosh as vetes ndaj dhe, duke dyshuar se mund t'i keqpërdorë memoaret e mia, vendosa që t'i botoj vetë, në këtë faqen time elektronike…

Babai im i ndjerë, policinë jugosllave e kishte frikë në palcë. Më lutej e më qortonte që mos të përzihesha me nacionalistët kosovarë, më luste që të isha lojalistë dhe të kisha kujdes, sepse me policinë jugosllave më mirë kalohet duke i shërbyer se sa duke i kundërshtuar". (Memoari nr. 1)

Në memoarin nr. 3 Sulejman Rexhepi evokon kujtime nga periudha kur ishte nxënës në Medresenë e Prishtinës. "Jasht Medresesë gjithçka tjetër ishte marksizëm-leninizëm. Vlonte Kosova nga kjo ideologji. Pa dyshim, marksizëm-leninizmi kishte future ndikimin e vet edhe në Medresenë tonë. Sot, kur e kujtoj atë kohë, më vjen të turpërohem prej atyre mësimeve dhe prej atyre hoxhallarëve komunistë që na mbushnin si bateritë e zbrazura me këtë ideologji. Ishte kohë e tillë, po na përgatisnin të bëheshim hoxhallarë komunistë. Komunistët e dinin se përmes hoxhallëkut, përmes kontaktit me xhemat dhe influencimit tonë mbi ta, më se lehti do të përhapej marksizëm-leninizmi, më së lehti do të zhvillohej bashkim-vëllazërimi, më së lehti do të luftohej nacionalizmi shqiptar i cili ishte dhe mbeti gogol i komunizmit jugosllav".

Nga edukimi që kishte marrë nga "hoxhallarët komunistë", Sulejman Rexhepi veçon Mulla Rashitin, i cili e krahasonte me Gjorçe Petrovin (revolucionarin sllavo-maqedonas). "Jo që kisha njohuri mbi këtë figurë historike maqedonase, por, çuditërisht, sa herë më thoshte Gjorçe Petrov, seç ma përshkonte trupin një zjarr, në prush. Biles kështu më thoshte edhe Mulla Rashiti: "O bir, o Gjorçe Petrov, o krejt "zhar" je bre…".Ja çka do të thotë mishërimi me historinë e huaj! Më vonë do të më thonë edhe Skenderbe por, kurrë nuk më ka ndjer trupi atë zjarrin e "zharit", për vetë faktin se emrin Skenderbe e kam dëgjuar shumë vonë, ndërsa me emrin Gjorçe Petrov, jemi rritur, rruga për në Sullaren time i binte nëpër lagjen e Gjorçe Petrovit, pazarin e mjekimin e kemi bërë në këtë lagje. Unë Gjorçe Petrovi në mes të Prishtinës?! E dija që nuk isha, por nuk e kuptoja se pse trupi flakë më shkonte kur më thoshin me këtë emër, pse trimërohesha dhe pse përpiqesha ta imitoj këtë "vojvodë"! Dhëndër u futa si Gjorçe Petrov kurse dola si plak i urtë, dola me plane të qarta për jetë. Zoti ishte me mua. Në mua vdiq Gjorçe Petrovi! Tash e tutje, për të tjerët do të isha Sulejman Rexhep!" (Memoari nr. 2)

Nga kujtimet që i kanë mbetur nga sjellja e Mulla Rashitit, Sulejman Rexhepi përmend edhe rastin kur ky imam i kishte zënë me femra në një lokal të Prishtinës, atë së bashku me Adnan Eminovin dhe Vesel Dautin. Nuk është me interes për temën tonë se si ua shau nënën ky teolog. Ajo që është e domosdoshme të përmendet, se Sulejman Rexhepi pohon se "të tre hoxhallarët përfunduan si hyzmeqarë të UDB-së" (Memoari nr. 3).



*Bardhyl Mahmuti në ballë të demonstratave në vitin 1981.*

Në memoarin nr. 28 Sulejman Rexhepi evokon shpërthimin e revoltës së vitit 1981 dhe mobilizimin e të gjitha strukturave politike dhe fetare për shkatërrimin e nacionalizmit shqiptar.

Ai pohon se "pas vitin 1981, të gjithë strukturat policore si dhe të zbulimit e të kundërzbulimit jugosllav u aktivizuan në luftë kundër nacionalizmit dhe seperatizmit shqiptar. Një luftë speciale po zhvillohej sidomos kundër mërgatës shqiptare e cila, e organizuar nëpër klube shqiptare, gjithandej qendrave evropiane, po i jepte krah dhe zemër seperatizmit shqitar në Kosovë si dhe nacionalistëve shqiptar në Maqedoni, Luginë të Preshevës si dhe në Mal të Zi. Nëpër organet gjegjëse ishte bërë një ristrukturim i kuadrit, nuk dihej se kush ku kishte shkuar dhe kush ku do të vinte. Në Maqedoni, neve shqiptarëve projugosllavë na e kishin sjellë, apo më mirë me thënë, na e nxorën përpara njëfarë Kire Fuzofski (Crni) ekspert në luftën kundër separatizmit shqiptar. Çuditërisht, që në takimin tonë të parë, për njëri tjetrin e ndjemë një dashuri të veçantë shoqërore. Do të bëhemi miq për tërë jetën. Ai ishte shumë i sinqertë ndaj meje. Pas disa muajve, kërkoi t'ia kryej me besnikëri një shërbim shumë interesant dhe, që në fillim më tha se, nëse e kryej këtë punë atëherë do t'i kem të gjitha dyert hapur, do të jem më i respektuar dhe më i dashuri në repartin e tij. Meqë në Kosovë njiheshin të gjithë në mes vete dhe, ekspozimi i spiunëve apo i bashkëpunëtorëve ishte i vështirë, kërkonin që nga ne, shqiptarët e Maqedonisë, t'i kryejmë përcjelljet e nacionalistëve dhe të seperatistëve shqiptarë, meqë më pak kishim rënë në sytë e tyre". (Memoari nr. 28).

Në memoarin nr. 32 të titulluar "Unë dija ta luftoja nacionalizmin shqiptar", spiuni i UDB-së, Sulejman Rexhepi, nxjerr në dritë disa të dhëna interesante që lidhen me ngjarjet e vitit 1981.

"Demonstratat e studentëve në Kosovë, në vitit 1981, i dhanë leje të plotë policisë jugosllave për të vepruar lirshëm mbi shqiptarët që shquheshin qoftë edhe me më të voglën shenjë të nacionalizmit dhe irredentizmit. Shqiptarët u shndërruan si në lepujt e egër të Zhedenit të cilët duhej mbytur sapo të dalin në shënjestër. Me qindra orë ligjërata u zhvilluan në trajnimin e njerëzve specialë që do ta luftonin këtë murtajë e cila po i kanosej shoqërisë jugosllave dhe po i tundte vetë themelet e ish-Jugosllavisë. Shoku Tito kishte vdekur kurse gjithnjë e më fuqishëm këndohej kënga "DruzheTito mi ti se kunemo, da sa tvoga puna ne skrenemo" (Për ata që nuk e dinë gjuhën serbe teksti i kësaj kënge do të thotë: "Shoku Tito ne të betohemi se nga rruga jote nuk do të largohemi" - Sqarimi BM)! Ne, pro jugosllavët, këtë këngë e kishim moto të jetës, e kishim lutje të ditës, e kishim parim dhe përcaktim jetësor.

Në KQ të LKM-së (Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë-sqarimi BM) u soll vendimi që në këtë aksion të gjerë të përfshiheshin edhe hoxhallarët, sepse ndikimi ynë ishte i madh. U ftuan disa hoxhallarë me ndikim në trajnim por, nuk kaloi asnjëri, madje të gjithë u bënë me nishan, u bënë të dyshimtë, sepse në ligjëratat e tyre ishin tepër të butë, tepër anemik, si ato melaqet që i hapin dyert e xhenetit dhe që i thonë xhenetlinjëve, hajde, urdhëroi, urdhëroni në xhenet! Para xhematit, sidomos para shqiptarëve në xhami, karshi egërsirës së tyre duhej të flitej me egërsinë edhe më të ashpër, karshi tyre duhej demonstruar tërë fuqia e pushtetit jugosllav, me zë të lartë e me gjeste duhej mbjellë frikë e jo butësi. Unë u përzgjodha si njeri më i ashpër, si njeri i përshtatshëm, sepse derisa në orë kursi mbaja prova si të luftohet nacionalizmi dhe seperatizmi shqiptar, më bëhej sikur nxirrja flakë nga goja, fjalët më dilnin si të zjarrta, sikur nuk nxirrja fjalë por gaca, prush. Kurse Kire Fuzofski bërtiste: "Taka "zharko", taka, davajzhar… zhar… zhar…"

Shoqata 'Ilmije' që funksiononte në kuadër të BFI-së dhe e themeluar nga KQ i LKM-së, u caktua që të jetë bartëse e organizimit të mbajtjes së ligjëratave nëpër organet e BFI-së si dhe nëpër xhamitë e vendit. Nuk ishte aksion i letë. Intervenimet policoro-ushtarake jugosllave në Kosovë, pamjet trishtuese që erdhën nga atje, por edhe proceset gjyqësore që vazhduan pastaj kundër udhëheqësve të demonstratave të Prishtinë e gjetiu, kishin pezmatuar mbarë shqiptarët, prandaj edhe nuk ishte e lehtë të dilje para xhematit shqiptar e të flisje kundër asaj lëvizje që në fakt ishte projekt i imerializmit amerikan për ta shkatërruar Jugosllavinë. Prandaj, kërkova dhe ma mundësuan që të pajisesha me armë dhe me leje, m'u dha liria e plotë që, nëse vetëm më shikon shtrembër ndonjë irredentist shqiptar ta vrisja në vend, si derrin e egër. Arma në brez më jepte siguri, më jepte forcë, ma shtonte flakën dhe prushin kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar. **(Vijon)**

# Keni rënë në peshë pa dietë? Ja 6 arsye për t'u shqetësuar

Luhatjet e vogla të peshës gjatë vitit janë normale, por në qoftë se rënia është më e rëndësishme dhe mbi të gjitha, për asnjë arsye, ju duhet t'i nënshtroheni një kontrolli për shkak se ajo mund të jetë tregues i një gjendje të rëndë shëndetësore



**Probleme me tiroidet –** Një nga simptomat më të zakonshme të hipertiroidizmit (dmth, kur tiroidja është tepër aktive) është humbja e peshës. "Nëse ju dyshoni për një problem me tiroidet, ju ndoshta do të përjetoni një oreks në rritje, por do të vuani nga humbja e kileve – tha Dr. Anne Cappola, endokrinolog dhe profesor i mjekësisë në Universitetin e Pensilvanisë. Por ju gjithashtu mund të keni vështirësi në gjumë ose të vareni nga një ndjenjë e vazhdueshme ngrohtësie.

**Sëmundja e zorrëve –** Sëmundja "Celiac" – domethënë, inflamacioni kronik i zorrës së hollë, shkaktuar nga gëlltitja e glutenit te personat predispozuar gjenetikisht mund të rezultojë me humbje peshe dhe zakonisht shoqërohet nga çrregullime të tjera gastrointestinale të tilla si dizenteri. "Edhe një problem me pankreasin, i cili prodhon enzimat që i vijnë në ndihmë tretjes, mund të çojë në një humbje të papritur të peshës", thotë Jamile Wakim-Fleming, gastroenterologist në Klinikën Cleveland. Në këtë drejtim ai rekomandon për t'i kushtuar vëmendje simptomave të tilla si dhimbje barku, të përziera pas konsumimit të vakteve, veçanërisht ushqimeve të yndyrshme, të tilla si hamburgerë.



**Diabeti –** Sidomos në një fazë të hershme, diabeti në fillim mund të sjellë humbje peshe. "Në disa raste ju gjithashtu mund të ndjeni një etje të pamotivuar, të kombinuar me një nevojë të vazhdueshme dhe urgjente për të urinuar", shton Dr. Cappola. Diabeti gjithashtu mund të shtyjë trupin për të marrë nga muskujt ushqimin që i nevojitet, gjë që shpjegon humbjen e papritur të peshës.

**Depresioni –** Së bashku me irritimin dhe problemet e gjumit, humbja e oreksit është një nga efektet anësore më të zakonshme të depresionit, si dhe ajo që mund të shkaktojë një rënie të konsiderueshme në peshë. "Shpesh njerëzit as nuk e kuptojnë se po humbasin peshë, sepse janë të zhytur në depresion", thekson Cappula.

**Dieta e varfër –** Në moshën e pjekur, humbja e peshës – dhe jo shtimi në peshë – shpesh lidhet me një rrezik më të madh të vdekshmërisë. "Kjo është ajo që shumë ekspertë e quajnë 'paradoks i trashjes'" dhe shpjegohet nga fakti se, me rritjen e moshës, stomaku tenton të zbrazet më ngadalë, gjë që e bën të ndiheni të plotë më gjatë, ndërsa disa nga impulset e trurit që kontrollojnë oreksin dhe ngopjen zvogëlohen. E gjithë kjo i shtyn njerëzit e moshuar për të ngrënë më pak, por duke bërë kështu, ata privojnë trupin e tyre nga lëndët ushqyese që kanë nevojë dhe përfundojnë në mënyrë të pakthyeshme me humbjen e peshës.

**Kanceri –** Disa lloje të kancerit, si dhe një ulçerë në stomak ose zorrë, mund të shkaktojnë inflamacion ose probleme të keqpërdorimit që çojnë në humbje të papritur të peshës. "Kur një pacient vjen tek unë, duke u ankuar për humbje peshe të pashpjegueshme, gjëja e parë që bëj është të shoh në stomak, zorrën e trashë dhe zorrët, në një kërkim për një kancer të mundshëm ose inflamacion", pranon Dr. Wakim-Fleming.

Ai thotë se gjithashtu kontrollon për tumore të mundshme në ezofag, të cilat mund ta vështirësojnë tretjen.

*(gazeta-Shqip.com)*






# Richard Gere martohet për herë të tretë



Richard Gere është martuar për herë të tretë. Aktori i ka dhënë fund beqarisë duke u martuar me të dashurën 33 vjet më të re, Alejandra Silva. 68-vjeçari u shpreh se është njeriu më i lumtur në univers. Ylli i "Pretty Woman" ka zhvilluar ceremoninë martesore në fermën e tij jashtë Nju Jorkut. "Unë jam njeriu më i lumtur në univers", ka deklaruar Gere në një intervistë për "Hello!"



# Rita falënderon shqiptarët pas koncertit në Tiranë

Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, ka mbajtur një koncert gjigant të dielën në Tiranë. Mijëra qytetarë u mblodhën në Sheshin "Skënderbeu" për ta parë nga afër interpretimin e artistes shqiptare. E impresionuar me mikpritjen që i është bërë në kryeqytetin shqiptar, ajo ka vendosur t'i falënderojë fansat në rrjetin social "Instagram". "Të gjithë ju 250 000, ju falënderoj për shfaqjen. Ju mund të jeni kudo në botë dhe keni qenë atje me mua. Gjithsecili që ndihmoi në ngritjen e kësaj shfaqje, së bashku me Erion Veliajn dhe sponsorët. Unë kalova kohën më të mirë ndonjëherë. Verona është destinacioni i radhës", ka shkruar Rita.

# Dua Lipa tregon se me kë ëndërron të ketë bashkëpunim



Këngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, ka zbuluar një sekret se me kë ka dëshirë të ketë bashkëpunim. Bëhet fjalë për Kevin Parkerin, këngëtar nga Australia. Artistja e "New Rules" këtë e ka pohuar gjatë një interviste para performancës së saj të fundit në hapjen e Ligës së Kampionëve të UEFA-s, mes Real Madridit dhe Liverpoolit.

# Pamja e re e Johnny Deepit i ka shqetësuar fansat






Aktori i famshëm Johnny Depp i ka habitur fansat e tij gjatë turneut të Rusisë me grupin e tij rock. Ata e komentuan për pamjen e zbehtë dhe të Johnnyt. Një fans i shqetësuar thotë: "Ai duket i zbehtë këtu. Shpresoj se ai është në rregull".



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | FUTBOLLISTI NË FOTO | DOKUMENT I VJETËR PËR PRONËSINË E TOKËS (shq.) | GAZ PA NGJYRË, ME ERË TË KEQE E TË FORTË | ORGAN NË PJESËN E POSHTME TË FYTYRËS SË NJERIUT (shq.) | PEMË FRUTORE ME TRUP TË LARTË E TË TRASHË | TONI ADAMS | EPOKA E RE | EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN | AKTORI .... SHEHU | TOKA E PUNUAR |
| | | | | | | | MATINA | | | | | | | E KAPËRDIJ (bised.) | | | |
| | | | | | | | NJËRA NGA ORGANIZATAT MË KRIMINALE MAFIOZE NË ITALI | | | | | | | MARYLAND ASSOCIATION REALTORS / MOTOÇIKLISTI VALENTINO | | | |
| | | | | | | | KRAHINË NË KOSOVË | | | | | | KLUB FUTBOLLI NË HOLANDË / FUTBOLLISTI FRANCEZ ..... NASRI | | | | |
| | | | | | | | HUMORISTI BESIM .... | | | | | KËNGËTARJA .... MALAJ / NAPA E HOLLË | | | | | QELESHJA |
| | | | | | | | RADIO TELEVIZIONI PUBLIK ITALIAN (shk. origj.) | | | | VËLLIMI, SASIA / KËNGËTARI I YNI I NJOHUR (Nofka) | | | | | BASHKËT. / GUXIMTARI | |
| | | | | | | | ZANORE | | AKTORI HOLLIVUDIAN SANDLER (shq.) / LECKA PËR ARNIM | | | | | | TAJVANI, LIBERIA / BASHKËT. | | |
| | | | | | | | SMIRA | | | | | | | NJË NGJYRË / EMËR YNI DJALI (shq.) | | | |
| EPOKA E RE | KANCELARIA GJERMANE NË FOTO | KËNGËTARJA E FAMSHME ..... ROSS | FUTBOLLISTI TURK BELOZOGLU | LIGUE EUROPENNE NATATATION | SHTRESA E SIPËRME E AJRIT | EPOKA E RE | DY BASHKËTINGËLLORE / MALTA | | | POLITIKANI SHQIPTAR NDOKA / TITULL ARISTOKRATËSH | | | | | IDRIZ SEFERI / POROSIA E FUNDIT | | |
| KËNGËTARE E FAMSHME BRITANIKE | | | | | | VUAJTJE E MADHE / ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. origj.) | | | | | | | FUTBOLLISTI FRANCEZ ADIL .... / KËNGËTARE E JONA | | | | |
| BEREQETI (krah.) | | | | | | | "... PAOLO" | | | | KOHA KUR NIS TË ZBARDHË DITA / ISH PRESIDENTI PALESTINEZ MAHMUD | | | | | | SHKRONJA TË NJËJTA |
| AKTORJA AMERIKANE JENNIFER | | | | | | | BASHKËT. / EMËR MASHKULLI MYSLIMAN | | NAIM ABAZI / SHARRËZ, SËMUNDJE E RËNDË (shq.) | | | AKTORJA E VJETËR ... RINA / ZANORE | | | | SHKRONJA E XXVIII / LLOJ QERREJE KUAJSH | |
| ELEKTRON, NEON | | | | FARISHTË / PUSIA | | | | | | TULLUMBACET / DIÇKA E RE | | | | | | | |
| NOTË MUZIKORË | | | 3.14 (mat.) / RRËMUJË, SHKEL E SHKO | | | SKANDALI / DY ZANORE | | | | | | I PLOGËT / AGIM KASAPOLLI | | | | | |
| ZANORE | | FLORI / FUTBOLLISTI GANEZ MICHAEL | | | E PËRFUNDOVA / LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE | | | | | | | | INTENSITET, TANTAL / AKTORI HOLLIVUDIAN EASTWOOD (shqip.) | | | | SHKENCA QË STUDION TË BUKURËN |
| QË KA MERITA | | | | | | | | AVNI SELMANI / DY BASHKËTINGËLLORE | | | KUVENDI I KOSOVËS / TRUP QË BIEN NGA QIELLI (shq.) | | | LUFTËTARJA SHQIPTARE PALIKUQI / KADRI KASTRATI | | | |
| PIKTORI VALLA (shq.) | | | | | | IRNOSJE (bised.) / ZAKONI | | | | | | LËVIZJA KOMBËTARE / PAMELA ANDERSON | | | ANTIGONA SEJDIU / VARG MALESH NË ZVICËR | | |
| RI PESHOVA | | | | | | | FJALË POHUESE / ZANORE | | | NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE / AKTORJA JESSICA | | | | | | BASHKËT. / LAG SËRISH | |
| KARNATAKA EXAMINATION AUTHORITY | | | | MENDIM / KRYEHOXHË | | | | DJALL, SHEJTAN / VEPËR E KRIMINELIT | | | | | | LITËR, RENIUM / BASKETBOLLISTI TURK .... ONAN | | | |
| KËNGËTARI I FAMSHËM IGLESIAS (shqip.) | | | | | | | KILOGRAM (bised.) / OLIVER (shk.) | | | | | ÇMPREH (bised.) / "... SIRO" | | | | | |
| BASHKËT. | | FILLESTAR, DILETANT / BERAT LUZHA | | | | | | | SHEF (bised.) | | | | MELIHATE (perkdh.) / DY BASHKËTINGËLLORE | | | | |
| EPOKA E RE | BRAGA / BASHKËT. | | KOMPOZITORI KOCI (shq.) / ZANORE | | | | | | BANORE E ARABISË / ANGOLA | | | | | | ADRIAN KRASNIQI / ZANORE | | |
| TËRËSIA E KUSHTEVE METEOROLOGJIKE | | | | | | GRIMCOVA (bised.) | | | | MASHTRIMI, DREDHIA | | | | | | | |

E jashtëzakonshme

## Çadra që ju ndjek kudo që shkoni



Një kompani japoneze po e dërgon teknologjinë e dronëve në një tjetër nivel. Ata kanë krijuar një çadër autonome që ndjek përdoruesin e saj, duke i qëndruar sipër kokës. "Free Parasol" përdor një aparat fotografik dhe inteligjencën artificiale për ta sinjalizuar dhe ndjekur përdoruesin e çadrës derisa ai ecën në rrugë, raporton "Daily Mail".

FOTO E DITES



Njësia aerobatike e Forcave Ajrore të Italisë shihet duke bërë përgatitje për ta përhapur tymin me ngjyrat e flamurit italian. /AFP/

E rrallë

## Bën 'selfie' me gruan e sapoaksidentuar nga treni



Një djalë i ri ka bërë një "selfie" derisa urgjenca ishte duke i ardhur në ndihmë një gruaje të aksidentuar nga një tren. Ngjarja ndodhi më 26 maj në stacionin e trenit të Piacenzas në Itali dhe u dokumentua nga një fotografi e gazetarit Giorgio Lambri, publikuar nga e përditshmja "Liberta".

## BARSOLETA E DITËS



**- Mirëmëngjesi, komshi! Në punë po shkon a?**

**- Jo, komshi, po dola t'i provoj pantallonat qysh po më rrinë.**

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,




Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo

**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

